



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-30501 dt. 01/08/ 2025

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 21.07.2025, e cila filloi në ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Bekim Lestrani-kryesues.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Malësore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV), Hamit Kastrati (PDK).

I pranishëm ishte edhe: **Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci.**

Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 19.06.2025;
2. Plan i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit dhe pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Drenasit për vitin 2024;
3. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale janar-qershor 2025;
4. Raporti financiar janar-qershor 2025;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa tha se kemi edhe një pikë shtesë, Raporti financiar janar-qershor 2025 dhe hodhi në votim rendin e ditës dhe kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e parë të rendit të ditës: Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt.19.06.2025. Me që nuk pati nuk pati diskutime kaloi në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e dytë të rendit të ditës: Plan i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Drenasit për vitin 2024.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, siç e dini ne jemi të obligum me ba Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës edhe me ligj e kemi obligim dhe duhet me e kalu në Kuvend si pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, me që nuk nuk pati vërejtje, sugjerime, kryesuesi hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e tretë: Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale janar-qershor 2025.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, edhe raportin e kemi obligim me ligj që një herë në gjashtë muaj me raportu për punën nga janari deri qershor.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi nuk pati vërejtje, sugjerime, hodhi në votim pikën e tretë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, e kemi edhe një pikë shtesë siç e prezantova në fillim të mbledhjes, pika e katërt: Raporti financiar janar-qershor 2025.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, edhe për raportin financiar është e njëjta, e kemi obligim ligjor me dërgu në Kuvend dhe atje mund të diskutojm për shifra për numra, mund me ju njoftu që prej një janarit deri me sot përmabruesi na i ka marrur mbi 2 milion e 800 mijë euro për shkakë të kontratave kolektive që na dëmton në shumë projekte zhvillimore të Komunës kur e kemi parasysh që mbi 6 milion euro është buxheti e deri në muajin e shtatë t'i marrin afër 3 milion llogariteni se qka mund të bëjmë me mjete tjera e që presim që deri në fund të vitit të na marrin edhe shuma milionshe tjera.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi nuk pati diskutime vërejtje sugjerime, hodhi në votim pikën e katërt të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e pestë:
Të ndryshme. Diskutime nuk pati.

Mbledhja përfundoi në ora 10:15.

Procesmbajtësja



Fakete Hoti

Lekturoi



Nikelinda Bujupi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Bekim Lestrani